



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Nr. _____ Prot.

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo	
Ministria e Financave / Ministarstvo za Financje	
Ministry of Finance	
Administrata Tatimore e Kosovës / Poreska Administracija Kosova / Tax Administration of Kosovo	
ARKIVA / ARHIVA / ARCHIVE	
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No
	28. 09-06-22/4
Nr. i Faqeve Broj stranica No. pages:	Data Datum Date
	07.09.22
DOKUMENTI A	

REPUBLIKA E KOSOVES

MINISTRIA E FINANCAVE

ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVES

Nr. 09-06-22/4 Prot

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

midis

Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve (DPT), i cili është autoriteti kompetent për qëllimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit, **përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm z. Gazmir SPAHIJA**, që këtu e më poshtë do t'i referohemi si palë,

dhe

Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), i cili është autoriteti kompetent për qëllimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit, **përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm z. Behxhet HALITI**, që këtu e më poshtë do t'i referohemi si palë,

NË MBËSHTETJE TË vullnetit të përbashkët për të rritur nivelin e bashkëpunimit, zgjerimit të marrëdhënieve dypalëshe me përfitim ngritjen profesionale të stafëve respektive, shkëmbimit të eksperiencave në fusha të para me prioritet nga të dy Administratat Tatimore;

DUKE KONSIDERUAR kontributin e secilës palë për forcimin e shtetit ligjor, luftën kundër korrupsionit, konfliktit të interesave, veprimeve që çenojnë mirëfunksionimin e administratës publike dhe në

të njëjtën kohë mbrojtjen e interesave të shteteve dhe të shtetasve respektivë;

DUKE SYNUAR

që ky bashkëpunim do të rezultojë në një kontribut të efektshëm në këtë fushë;

DUKE AFIRMUAR

vendosmërinë për respektimin reciprok të legjislativëve respektive të fushave përkatëse, gjatë proceseve respektive të punës së të dy institucioneve;

Palët bien dakort mbi Marrëveshjen e Bashkëpunimit si më poshtë:

**NENI 1
OBJEKTIVI**

- 1.1 Kjo Marrëveshje do të aplikojë procedurat që thjeshtojnë bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve të palëve.
- 1.2 Bashkëpunimi përmendur në paragrafin 1 do të zbatohet mbi baza të njëjta dhe mbi parimin e reciprocitetit.

**NENI 2
KONTRIBUTE TË PËRBASHKËTA**

- 2.1 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Administrata Tatimore e Kosovës, marrin përsipër në organizimin e bashkëpunimit në formën e:
 - Shkëmbimeve të eksperiencës në formën e takimeve dhe vizitave studimore rajonale dhe qëndrore, të cilat do të mundësojnë takime ekspertësh dhe niveleve drejtuese të të dy palëve;
 - Organizimit të seminareve, grupeve të punës, trajnimeve ose konferencave;
 - Shkëmbimit të informacioneve në fushën legjislative dhe procedurale në lidhje me aktivitetin e palëve;
 - Projekteve të posaçme, që do të mund të studiohen dhe organizohen bashkërisht nga palët, në rast nevojë dhe me interes të përbashkët;
 - Koordinim të veprimeve të përbashkëta në zonat ndërkufitare, sipas juridiksioneve përkatëse.Sipas një programi vjetor, Palët bien dakord për subjektet që do të trajtohen. Ato mbeten në kontakt për të organizuar veprimtaritë. Në momentet e përshtatshme, Palët paraqesin informacione ose modifikime që mund të kenë pasoja mbi përgatitjen dhe zhvillimin e mbarë të veprimtarive.

- 2.2** Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve dhe Administrata Tatimore e Kosoves, marrin përsipër të informojnë reciprokisht njëri-tjetrin për rezultatet e veprimtarive te perbashketa, nivelin e perfaqesimit apo informimin publik te aktiviteteteve te tyre.
- 2.3** Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve dhe Administrata Tatimore e Kosoves, marrin përsipër të bashkëpunojnë për organizimin e aktiviteteteve të përbashkëta, si për ti ofruar njeri-tjetrit shërbime të ekspertizës dhe trajnimit për fushat respektive të veprimtarisë, ashtu edhe për të rritur ndërgjegjësimin e administratave tatimore në parandalimin dhe shmangien e praktikave korruptive dhe abuzive.

NENI 3 KOORDINIMI NDËRMJET PALËVE

- 3.1** Palët për zbatimin e kësaj marrëveshje caktojnë nga një person kontakti për secilin institucion.
- 3.2** Personat e kontaktit do të mbajnë takime ndërmjet tyre në vazhdimësi, në varësi të nevojës për shkëmbim informacioni. Objekti i shkëmbimit të informacionit ndërmjet tyre do të jetë sipas nenit 1 të kësaj marrëveshje.
- 3.3** Personat e kontaktit do të informojnë në vazhdimësi drejtuesit e dy institucioneve në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshje.

NENI 4 DISPOZITAT E FUNDIT

- 4.1** Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar.
- 4.2.** Amendamentet mund të bëhen me marrëveshje nga Palët nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim, duke saktësuar datën e hyrjes në fuqi.
- 4.3** Çdo mosmarrëveshje krijuar mbi interpretimin ose ekzekutimin e këtij Marrëveshjes do të zgjidhet me marrëveshje dypalëshe.
- 4.4** Përveç parashikimit të paragrafit 1 të këtij neni, kjo Marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë nga secila palë, duke njoftuar paraprakisht 60 ditë para me shkrim, palën tjetër.
- 4.5** Marrëveshja hartohet në gjuhën shqipe, përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Drejtorinë e Pergjithshme te Tatimeve dhe dy të tjera në Administratën Tatimore te Kosoves.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi u nënshkrua sot, më datë 07/09/2012.

**PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME
TË TATIMEVE**

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

GAZMIR SPAHIJA



**PËR ADMINISTRATËN TATIMORE
TË KOSOVËS**

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

BEHXHET HALITI

